

# KUJDES!

- Mos harroni të kodoni grupin (A ose B) në fletëpërgjigjen e provimit. **Fletë-përgjigjet me grupin e pakoduar nuk vlerësohen.**
- Çdo pyetje ka vetëm një përgjigje të saktë. Nëse një pyetjeje i jepni dy përgjigje atëherë ajo pyetje do të vlerësohet si e gabuar.
- Përgjigja do të kodohet me laps. Në të kundërt kompjuteri nuk do ta lexojë.
- Përgjigjen e pyetjes do ta kodoni vetëm brenda rrethit siç është vepruar në shembullin e poshtëshënuar

Saktë  A  B  C  D

Gabim  A  B  C  D

- Bëni kujdes për të mos dalë jasht rrethit kur të kodoni përgjigjen.
- Mos bëni asnjë veprim mbi fletë përgjigjen e provimit si zhgarravitje, rrudhosje etj.
- Mos iu përgjigjini pyetjeve për të cilat nuk jeni të sigurtë. **Kujdes! 3 përgjigje gabim fshijnë një të saktë.**
- Mos qëndroni shumë tek pyetjet që nuk zgjidhni dot, sepse koha mund të mos ju mjaftojë për t'iu përgjigjur pyetjeve të tjera.
- Koha e provimit është **150 minuta**. Shfrytëzoni deri në fund kohën e provimit. Në qoftë se ju tepron kohë, bëjini dhe një kontroll testit.
- Përgjigjet e pyetjeve që ndodhen në këtë libërth, do të kodohen në fletë-përgjigje në pjesën ku shkruan "PERGJIGJET".
- Në provim **ndalohet** mbajtja ose përdorimi i celularit dhe makinës llogaritëse.
- Kodoni me kujdes preferencat tuaja për shkollat në të cilat dëshironi të studioni. Rezultatet dhe bursat do të shpallen sipas preferencave të bëra.

Shkolla	Kodi
"Mehmet Akif" e Mesme - Vajza në Tiranë (me konvikt)	<b>01</b>
"Mehmet Akif" e Mesme - Djem në Tiranë (me konvikt)	<b>02</b>
"Turgut Özal" 9-Vjeçare dhe e Mesme në Tiranë (me konvikt)	<b>03</b>
"Hasan Riza Pasha" 9-Vjeçare dhe e Mesme në Shkodër (e mesme me konvikt)	<b>04</b>
"Turgut Özal" 9-Vjeçare dhe e Mesme në Durrës (klasat 9-12 me konvikt)	<b>05</b>

*Suksese!*

**1.**

Thjeshtoni shprehjen  $\frac{x^3 - 1}{x^2 - 1} \cdot \frac{x^2 + x}{x^2 + x + 1}$ .

- A)  $x$                       B)  $\frac{1}{x}$   
 C)  $\frac{x}{x+1}$                   D)  $\frac{x+1}{x}$

**2.**

Nëqoftëse  $\frac{a+b}{a-b} = 4$ , sa është vlera e  $\frac{a}{b}$ ?

- A)  $\frac{1}{3}$       B)  $\frac{2}{3}$       C)  $\frac{4}{3}$       D)  $\frac{5}{3}$

**3.**

Albanit, Mirit dhe Erionës i jepen 39 zarë në raport të drejtë me numrat 2:5:6, sipas radhës. Sa zarë duhet ti japë Eriona Albanit, që numri i zarëve të tyre të barazohet?

- A) 3      B) 6      C) 9      D) 12

**4.**

Gjeni vleren e  $x$ -it  $2 \cdot (3 + 2x) > 3x - 1$

- A)  $x \in ]-\infty; 7[$                   B)  $x \in ]-7; \infty[$   
 C)  $x \in [-7; \infty[$                   D)  $x \in ]-\infty; -7[$

**5.**

Eshtë dhënë  $x < 0$ . Cila nga të mëposhtmet është vlera e shprehjes  $\sqrt{(x)^2} + \sqrt[3]{(x)^3}$ ?

- A)  $-2x$       B)  $-x$       C) 0      D)  $2x$

**6.**

Kur lexon  $\frac{1}{8}$ -ën e një libri, dhe pastaj  $\frac{3}{5}$ -ën e pjesës së ngelur, mbeten 42 faqe pa lexuar. Sa faqe ka libri?

- A) 120      B) 112      C) 104      D) 160

**7.**

Gjeni vlerën e  $x$ -it nëqoftëse  $\frac{x}{4} - \frac{x-2}{3} = -1$

- A) 4      B) 14      C) 20      D) 24

**8.**

Gjeni vlerën e shprehjes  $\frac{(x)^{-3} \cdot (x^4)^3}{(x^{-3})^{-1}}$ .

- A)  $x^3$       B)  $x^{-3}$       C)  $x^6$       D)  $-x^6$

**9.**

Gjeni përfundimin e veprimit

$$\frac{\left(5 - \frac{1}{5}\right) - \left(3 - \frac{1}{5}\right)}{\left(3 + \frac{1}{3}\right) + \left(2 - \frac{1}{3}\right)}$$

- A)  $\frac{1}{5}$       B)  $\frac{2}{5}$       C)  $\frac{3}{5}$       D)  $\frac{4}{5}$

**10.**

$$\sqrt{2 - \frac{7}{4}} + \sqrt{1 - \frac{11}{36}} = ?$$

- A)  $\frac{4}{3}$       B)  $\frac{7}{6}$       C)  $\frac{2}{3}$       D)  $\frac{3}{4}$

**11.**

Jepen bashkësitë  $A = \{1, 2, 3, 4\}$  dhe  $B = [1, 3[$ .  
Numri i elementëve  $A \cap B$  është:

- A) 0      B) 1      C) 2      D) 3

**12.**

$$\frac{4}{0,02} + \frac{5}{0,5} - \frac{2}{0,4} = ?$$

- A) 200      B) 205      C) 210      D) 215

**13.**

Zgjidhni sistemin  $\begin{cases} 2x + y = 0 \\ x + 5 - 2y = 0 \end{cases}$

- A)  $(-2; 1)$                       B)  $(2; -4)$   
 C)  $(1; -2)$                       D)  $(-1; 2)$

**14.**

Rrënjet e ekuacionit  $x^2 - 6x + 2 = 0$  janë  $x_1$  dhe  $x_2$ . Gjeni vlerën e shprehjes  $\frac{1}{x_1} + \frac{1}{x_2}$ .

- A)  $-3$             B)  $3$             C)  $-\frac{1}{3}$             D)  $\frac{1}{3}$

**15.**

Mesatarja aritmetike e numrave  $a$  dhe  $b$  është 10, e numrave  $b$  dhe  $c$  është 14 dhe e numrave  $a$  dhe  $c$  është 12. Sa është mesatarja aritmetike e numrave  $a$ ,  $b$  dhe  $c$ ?

- A) 8            B) 10            C) 12            D) 16


**16.**

$$\left(1 + \frac{1}{3}\right) \cdot \left(1 + \frac{1}{4}\right) \cdot \left(1 + \frac{1}{5}\right) \cdot \dots \cdot \left(1 + \frac{1}{77}\right) = ?$$

- A) 78            B) 42            C) 39            D) 26

**17.**


Në figurën mëposhtë kuboidet e dhënë kanë përmasa të njëjta. Gjeni gjatësinë e  $[AB]$ -së.



- A)  $6\sqrt{5}$     B)  $6\sqrt{2}$     C) 7    D) 9

**18.**

Në figurë ABCD është katërkëndësh i mysët.  $\angle ABC = 90^\circ$   $[AC] \perp [BD]$ ,  $[AB] \perp [BC]$ . Gjej  $|BE|$ .




- A) 4    B) 6    C)  $4\sqrt{2}$     D)  $2\sqrt{5}$

**19.**

Gjej syprinën e trapezit ABCD.

- $[DC] \perp [BC]$   
 $[AB] \perp [BC]$   
 $|AB| = 16 \text{ cm}$   
 $|DC| = 8 \text{ cm}$   
 $|AD| = 10 \text{ cm}$




- A) 48    B) 72    C) 96    D) 144

**20.**

Gjej gjatësinë e brinjës së katrorit ABCD.

- $|AB| = |BC| = |CD| = |AD|$   
 $|EC| = 1 \text{ cm}$   
 $|AE| = 5 \text{ cm}$





- A) 3    B) 4    C) 5    D) 6

# UDHËZIM

PER MENYREN E ZGJIDHJES SE PYETJEVE LOGJIKE

**Shembull 1**

Cila është pllaka që mungon?



A B C D

**Udhëzim:** Duke u bazuar në dy rreshtat e parë vërejmë se shigjetat tregojnë vetëm 3 drejtime (djathtas, majtas dhe poshtë). Nga lartë poshtë numri i pllakave rritet me nga një shigjetë. Pra pllaka që mungon duhet të ketë 3 shigjeta me drejtim poshtë, ndryshe nga dy pllakat e tjera. Prandaj e vetmja përgjigje e saktë është D.

**Shembull 2**


Cila fjalë korrespondon me 3020?

2131  
6050  
3020                      3020 ⇒ ?  
4131  
5131


- A) YAKA                      B) SIVI                      C) TAKA  
D) VAKA                      E) KIYI

**Udhëzim:** Secila shkronjë korrespondon me një shifër. 3-shi gjendet në numrin e parë, të katërt dhe të pestë në shifërën e parafundit që korrespondon me gërmën K. Pra fjala që i korrespondon numrit 3020 fillon me K. E vetmja alternative që fillon me gërmën K është KIYI.

21.



Cila nga figurat e mëposhtme duhet të vendoset në vënd të pikëpyetjes?




A) B) C) D)

22.




Cila nga figurat e mëposhtme vjen më pas?



A) B) C) D)


**23.**

Cila nga figurat e mëposhtme është e ndryshme nga figurat e tjera?




**24.**

Cila nga figurat e mëposhtme është e ndryshme nga figurat e tjera?




**25.**


Duke bashkuar stampat e mëposhtme formohet një figurë.



Cila nga 4 figurat **nuk** mund te formohet nga bashkimi i stampave?




**26.**




Cili numër vjen në vend të pikëpyetjes?

- A) 5      B) 7      C) 11      D) 13


**27.**




Cila nga figurat e mëposhtme vjen më pas?




**28.**




Cila nga figurat e mëposhtme duhet të vendoset në vend të pikëpyetjes?



**29.**




Cila nga figurat e mëposhtme duhet të vendoset në vend të pikëpyetjes?




**30.**

Cila nga figurat e mëposhtme është e ndryshme nga të tjerat?




**31.**



Cili numër vjen në vend të pikëpyetjes?

- A) 44    B) 42    C) 40    D) 36

**32.**




Cili numër vjen në vend të pikëpyetjes?


- A) 66    B) 44    C) 33    D) 48

**33.**

Cila nga figurat e mëposhtme është e ndryshme nga të tjerat?




**34.**



	x	y	z
A)	5	6	2
B)	6	5	2
C)	2	5	6
D)	2	6	5




**35.**




Sa kuba ka në figurë?

- A) 34    B) 35    C) 36    D) 37



**36.**



Cila nga figurat e mëposhtme duhet të vendoset në vënd të pikëpyetjes?



**37.**




**38.**

2, 6, 7, 21, 22, X, Y


Numrat më lart janë renditur sipas një rregulli të caktuar. Gjeni sa është  $X + Y = ?$

- A) 47    B) 88    C) 105    D) 133

**39.**



Cila nga figurat e mëposhtme duhet të vendoset në vënd të pikëpyetjes?




**40.**

$\textcircled{23} \rightarrow 6$      $\textcircled{34} \rightarrow 12$      $\textcircled{56} \rightarrow 30$

$\boxed{23} \rightarrow 5$      $\boxed{34} \rightarrow 7$      $\boxed{56} \rightarrow 11$

$\triangle 3 \rightarrow 9$      $\triangle 4 \rightarrow 16$      $\triangle 5 \rightarrow 25$



- A) 19    B) 17    C) 15    D) 13

**71.**

Iu rikthehet dy figurave të njohura nëpërmjet figurës letrare të krahasimit në poezinë e tij:

- A) Dritëro Agolli
- B) Ismail Kadare
- C) Lasgush Poradeci
- D) Azem Shkreli

**72.**

Në romanin “Prilli i thyer”, trajtohet tema e:

- A) Gjakmarrjes
- B) Besës
- C) Dashurisë
- D) Faljes së gjakut

**73.**

“Këngët e Milosaos” është shkruar nga:

- A) Pjetër Bogdani
- B) Frang Bardhi
- C) Jeronim de Rada
- D) Gavril Dara

**74.**

Cila është forma e saktë drejtshkrimore:

- A) Mirëseerdhe!
- B) Mirëse erdhe!
- C) Mirë se erdhe!
- D) Mirë serdhe!

**75.**

Në “Iliadë” trajtohen:

- A) Ngjarjet e 10 viteve të luftës greko –trojane.
- B) Ngjarjet e 51 ditëve të fundit të luftës.
- C) Vetëm zemërimi i Akilit.
- D) Vetëm historia e “Kalit të Trojës”.

**76.**

Cila fjali e ka të shkruar saktë përemrin vector dhe trajtën e shkurtër të tij:

- A) U thashë ju.
- B) Ju thashë juve.
- C) Ju thashë ju.
- D) U thashë juve.

**77.**

Figura letrare kryesore në poezinë “Një vajzë” është:

- A) Simboli
- B) Metafora
- C) Apostrofi
- D) Epiteti

**78.**

Bën fjalë për martesën e të gjallit me të vdekurin pjesa:

- A) “Rinë Katerinëza”
- B) “Ai...”
- C) “Jesminë”
- D) “Pas betejës”

**79.**

Edit Durham ishte:

- A) Studiuuese e apasionuar e jetës shqiptare.
- B) Historiane korrekte angleze.
- C) Adhuruuese e cilësive tona më të mira.
- D) Të gjitha këto.

**80.**

Pjesa “*Rrno vetëm për me tregue*” ju kujton:

- A) At Gjergj Fishtën
- B) Fan Nolin
- C) At Ndre Mjedën
- D) At Zef Pllumin

**81.**

Poema “*Bagëti e Bujqësi*” e N. Frashërit ka tipare të përbashkëta me:

- A) Idilin
- B) Sonetin
- C) Himnin
- D) Elegjinë

**82.**

Tekstet letrare kanë si qëllim kryesor:

- A) Edukimin artistik të lexuesit.
- B) Sjelljen e informacionit.
- C) Funkcionin praktik.
- D) Udhëzimet e ndryshme.

83.

Në cilën fjali, folja “jam”, ka kuptim të plotë:

- A) Atyre u është thënë shpesh kjo gjë.
- B) Ata ju kanë njoftuar disa herë.
- C) Pranvera ishte e lagësht këtë vit.
- D) Të thashë që do të jemi në shtëpi të dielën.

84.

Në fragmentin: “Në dhomë u trazuan përnjëherë lebetitjet e fëmijës me atë të kërthiut... Po ç’ke qi kjan, moj ferishtë...”, fjalët e nënvizuara janë:

- A) sinonime
- B) mbiemra
- C) antonime
- D) homonime

85.

Fjalët: *i njerëzishëm, sypetrit, trim, zemërbardhë*, i përkasin klasës së:

- A) Mbiemrit
- B) Emrit
- C) Përemrit
- D) Ndajfoljes

86.

Në fjalinë: “Gurëzit e lumit dukeshin si të larë në ar nga rrezet e diellit.”, fjala e nënvizuar është:

- A) Përcaktor me drejtim
- B) Përcaktor kallëzuesor i kryefjalës
- C) Përcaktor kallëzuesor i kundrinorit
- D) Rrethanor mënyre

87.

Në fjalinë: “Ajo pastroi tavolinën prej xhami që ishte në dhomën e saj.”, fjala e nënvizuar është:

- A) përcaktor me përshtatje
- B) përcaktor me bashkim
- C) përcaktor me drejtim
- D) ndajshkrim

88.

Në fjalinë: “Pulëbardhat zhyteshin për të kapur gjahun nën ujë.”, fjala e nënvizuar është:

- A) paskajore
- B) përcjellore
- C) pjesore
- D) mbiemër me parafjalë

**89.**

Fjala “*zbukurimin*”, është formuar me:

- A) parashtesë
- B) parashtesë e prapashtesë
- C) mbaresë
- D) prapashtesë

**90.**

Pjesa e nënrenditur në fjalinë: “*Ajo vinte nga një qytet, që ndryshonte nga i yni.*”, është e llojit:

- A) Kryefjalore
- B) Kallëzuesore
- C) Kundrinore
- D) Përcaktore

